



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 605/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.09.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “CETIS, Graphic and Documentations Services” në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-53828-03-06-2018 me objekt: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, me fond limit 16.915.000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 23.05.2018 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe e Pajisjeve Mjekësore.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “CETIS, Graphic and Documentations Services” dhe “Albdesign PSP” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

“Albdesign PSP” shpk
Rruga “Cerçiz Topulli”, Nr.17 Kashar, Tiranë

“Adel Co” shpk
Rruga “Muhamet Gjollësja”, Zogu i Zi, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
Rruga e Dibrës NR.359/1 Tiranë

Subjekt i Interesuar: “Cetis Graphic and Documentations Services”
Copova 24,3000 Celje, Slovenia, Europe

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 06.03.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-53828-03-06-2018 me objekt: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, me fond limit 16.915.000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 23.05.2018 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe e Pajisjeve Mjekësore.

II.2. Në datën 23.05.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 06.06.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

Eldino	pa ofertë	I skualifikuar
Farma Net Albania	pa ofertë	I skualifikuar
Dajti	pa ofertë	I skualifikuar
Cetis, Graphic And Documentation Services	9,955,800	I kualifikuar
Albdesign PSP	11,945,000	I kualifikuar
Kristalina KH	12 500 000	I skualifikuar
Adel Co	15,129,500	I kualifikuar

II.4. Në datën 13.06.2018 operatori ekonomik “Albdesign PSP” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

Public Health Sector

Kundërshtojmë kualifikimin e padrejtë të shoqërisë Cetis Graphic and Documentations Services” me arsyet si më poshtë:

- Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike sipas legjislacionit në fuqi në përputhje me të gjitha detyrimet përkatëse. Ky operator nuk ka arritur të paraqesë një vërtetim që nuk është debitor në lidhje me detyrimet e energjisë elektrike sipas kërkesave në kriteret e vecanta për kualifikim.
- Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin për ekstraktin pasi nuk vërteton se ka objekt të veprimtarisë së tij në fushën e shtypshkrimeve por e ka atë vetëm në fushën e shërbimeve grafike për këtë nuk ka paraqitur asnjë dokument sipas kërkesave për kualifikim të parashikuar në pikën 2.1 Kapaciteti ligjor/ profesional i OE.
- Nuk ka paraqitur balance të tre viteve të fundit të certifikuara të paraqitura pranë autoriteteteve përkatëse cka nënkupton certifikimin e tyre nga organet përkatëse. OR nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kërkesës së autoritetit kontraktor pasi nuk i ka paraqitur këto dokumenta të certifikuara.

- Nuk plotëson kriterin për certifikatat ISO pasi Certifikata ISO 14298 të sistemit të menaxhimit të sigurisë së proceseve të printimit dhe certifikata ISO 9001:2015 të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë nuk janë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur në RSH, ashtu sic është kërkuar në DT nga vetë AK.
- Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin për makineritë dhe pajisjet pasi në dijeninë tonë nuk disponon makineri printimi dhe llakimi në rulon dhe makineri numerator dixhital ose ekuivalente dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në DT nga AK për të vërtetuar këtë kriter sipas pikës 2.3 kapaciteti teknik.
- Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin për ambjentin e përshtatshëm pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për të vërtetuar një gjë të tillë. Operatori Cetis nuk e ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për të vërtetuar këtë kriter pra nuk ka akt pronësie ose kontratë qeraje shoqëruar me dokumentacionin përkatës duke mos përmbushur kërkesat e AK.
- Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin për mostrat (kampione) sepse nuk ka paraqitur të gjitha mostrat e kërkuara dhe ka mungesë fizike në dorëzimin e tyre në ditën e hapjes së ofertave, gjithashtu në ditën e hapjes së ofertave dhe dorëzimit të samples kompania e renditur e para në këtë procedurë nuk ka pasur asnjë përfaqësues duke na krijuar bindjen e plotë se kjo kompani nuk i ka dorëzuar të plota samples e kërkuara në këtë procedurë prokurimi duke mos plotësuar kështu kriterin e kualifikimit.
- Oferta ekonomike e operatorit Cetis është anomalisht e ulët dhe në dijeninë tonë mendojmë se nuk ka përmbushur dhe plotësuar të katër kushtet kumulative të përcaktuara në nenin 56 të LPP. Operatori ekonomik Cetis nuk ka argumentuar dhe dokumentuar me prova shkresore duke mbajtur në konsideratë të gjithë elementët të përcaktuar në Ligj dhe VKM ndaj oferta e tij nuk duhet pranuar si një ofertë që nuk krijon bindjen për realizimin me sukses të kontratës. Mosargumentimi i ofertës së paraqitur me dokumenta dhe prova shkresore dhe kualifikimi i tij në kundërshtim me përcaktimet e ligjit do të çojnë në një mosrealizim të kontratës pasi vlera e paraqitur nga operatori Cetis është gati 50% më poshtë se fondi limit duke paraqitur një rezik në kryerjen dhe realizimin e kontratës në cilësi dhe në kohë. Gjithashtu argumentimi i ofertës anomalisht të ulët është kërkuar edhe në rrugë elektronike edhe në formë shkresore për të cilën kemi bindjen se OE i renditur i pari nuk e ka depozituar një të tillë dhe për më tepër nuk e ka sjellë me anë të sistemit elektronik në faqen zyrtare të app.
- Sa më sipër përveç mosplotësimit të kriterëve ligjore pretendojmë se nuk mund të kualifikohet një ofertë e cila edhe nga ana ekonomike është e papërgjegjshme duke vënë në rezik realizimin e këtij objekti prokurimi, kështu përmendim faktin që kompania Cetis është një kompani e huaj dhe nuk ka asnjë përfaqësi në shtetin shqiptar. Në rastin e blerjes së mallit nga një kompani e huaj AK është e detyruar të kryejë

procedurë importi e cila sjell si pasoja: Të paguajë parapagim në masën 20% të vlerës së produktit për TVSH në doganë. Për OE shitja do të jetë export duke mos përfshirë vlerën 20% të TVSH. Në këtë mënyrë AK po kryen parapagim në vlerën 20% të shumës gjë e cila nuk është e parashikuar në DST pasi në to shkruhet se pagesa do të bëhet 30 ditë pas dorëzimit të mallit. Diskriminon operatorët e tjerë pjesmarrës vendas të cilët në analizën e tyre kanë përfshirë dhe koston e parasë për pagesën totale mbas 30 ditësh. Në kushtet e përgjithshme të kontratës së publikuar nuk është parashikuar dicka e tillë pasi sikurse në cdo procedurë tjetër mallrash AK lidh kontratën me subjektin fitues në mbështetje të cdo neni të saj.

II.5. Në datën 19.06.2018 me shkresën nr. 2104/40 prot, operatori ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje mospranimin e ankesës.

II.6. Në datën 25.06.2018, pala ankimuese “Albdesign PSP” sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 13.06.2018 operatori ekonomik “Adel Co” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

- *Shoqëria Cetis nuk ka paraqitur dokumentacionin e saktë dhe konform rregullave. Dokumentacioni i paraqitur në përmbushje të kriterëve të kërkuara nuk paraqet besueshmëri për shkak të formës së tij. Në DT në kriteret e përgjithshme për kualifikim përcaktohet “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe atherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Pra të gjitha dokumentat nga firmat pjesmarrëse të huaja duhet të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara. Në këtë rast ne mendojmë që dokumentat që janë përkthyer nuk përmbajnë firmën e përkthyesit në cdo fletë të cilat ato janë përkthyer duke mos krijuar kështu siguri që dokumentacioni i paraqitur është ai që është kërkuar në DST të noterizuara dhe të përkthyer. Legjislacioni shqiptar shprehet qartë për vërtetësinë e dokumentave të cilat duhet të mbajnë firmën dhe vulën e përkthyesit dhe noterit. Në kushtet që dokumentacioni i paraqitur në këtë procedurë ka mangësi në këtë pikë atherë dokumentacioni që është paraqitur në vërtetimin e këtyre kriterëve nuk është i vlefshëm dhe për pasojë kriteret e kërkuara në DST nuk plotësohen. Gjithshtu në DT është përcaktuar që dokumentat e paraqitura në tender duhet të jenë origjinale ose kopje të njehsuara me origjinalin. Ne mendojmë se kjo shoqëri ka paraqitur dokumentacion që është kopje dhe që është lehtësisht i modifikueshëm në cdo kohë. Në këto kushte kjo shoqëri duhet të skualifikohet nga kjo procedurë prokurimi.*
- *Në DT është kërkuar paraqitja e listës së informacionit konfidencial. Kjo listë është kërkuar të paraqitet sipas një formati të caktuar nga autoriteti juaj kontraktor. Ne mendojmë që ky dokument nuk është paraqitur në përputhje me formatin e kërkuar në DT dhe për pasojë kjo shoqëri duhet të skualifikohet.*

- Në DT është kërkuar certifikatë ISO 9001:2015 dhe certifikatë ISO14298. Ne kemi bindjen që në kundërshtim me DT kjo shoqëri nuk disponon dhe nuk ka paraqitur certifikatë ISO 9001. Pra në kushtet që ky dokument kërkohej në DT dhe nuk është paraqitur kjo kompani duhet të ishte skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi. Gjithashtu ISO e paraqitur nga ky operator nuk është e vlefshme sepse nuk është lëshuar nga një organizëm ndërkombëtar akreditues që të përmbushë kriterin dhe të jetë i njohur nga RSH.
- Shtojca 1 “formulari i ofertës”, kërkon të plotësohet me shifrat e shprehura në numra dhe në fjalë. Ne mendojmë se Formulari i Ofertës i kësaj shoqërie nuk përmban shumën në shifra por vetëm në fjalë duke mos qenë e rregullt sipas DST dhe LPP.
- Bilancet e paraqitura nga ky operator duhet të dorëzoheshin në formën reale. Ne mendojmë se bilancet e paraqitura nuk janë të plota dhe nuk përmbajnë informacionin e kërkuar duke mos i shërbyer procedurës së tenderimit. Gjithashtu kemi dyshimet tone se kjo shoqëri nuk ka paraqitur gjithashtu bilancin për vitin 2015. Ne mendojmë se kjo shoqëri ka dorëzuar bilancin në formën e një deklarate dhe jo bilancin në formën origjinale. Kështu deklarata e paraqitur nuk përmban firmën dhe vulën e organeve tatimore duke mos përmbushur kushtin të paraqitura në autoritetet përkatëse. Për më tepër ne dyshojmë që ky dokumentacion mund të mos jetë origjinal por një kopje e thjeshtë që nuk krijon kurfarë besueshmërie dhe pulla apostile nuk bëhet për deklaratat që jep firma por për dokumentat origjinale.
- Në DST kërkohej: Kopje të deklaratave të xhiros vjetore gjatë tre viteve të fundit në vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës limit të kontratës që prokurohet. Nga informacionet që ne kemi nga zhvillimi i procedurës në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria Cetis nuk vërtetohet kërkesa e mësipërme. Ne mendojmë se kjo shoqëri nuk e ka paraqitur këtë dokument.
- Në DT është kërkuar : 1-Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera dhe të realizuara gjatë tri viteve të fundit në vlerë jo më e vogël se **40% e vlerës limit që prokurohet**. 1- Per pervoja te meparshme: Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara Ose Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Kjo shoqëri nuk e përmbush këtë kriter dhe është kualifikuar në kundërshtim me LPP. Ne mendojmë që dokumentacioni i dorëzuar nga kjo kompani për vërtetimin e kontratave të ngjashme nuk vërteton që kontrata e mallrave është shtypshkrime por thjesht letër reference me shifër dhe jo objektin e kontratës. Gjithashtu duke marrë në konsideratë që furnizimet kërkohej të jenë të ngjashme dhe referuar natyrës së mallit që prokurohet natyrë e ngjashme konsiderohen mallrat që përmbajnë punime me elementë sigurie dhe nuk kanë vlerë deklarate e firmës që ne kemi bërë këto punime.....Ne mendojmë se në kushtet që në vërtetimin e paraqitur kjo

shoqëri nuk pasqyron asnjë prej elementëve të mësipërm kjo kompani duhet të ishte skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi.

- Kjo shoqëri nuk disponon makineri shtypi me rrulon, makineri llakimi në rrulon dhe makineri për numratorin dixhital. Në DT kërkohet që disponimi i këtyre makinerive të vërtetohet me anë të faturës së blerjes ose me kontratë qeraje. Ne mendojmë se ky operator nuk e vërteton disponimin e këtyre makinerive me asnjë prej kritereve të përcaktuara në DT. Ne kemi bindjen se ky OE ka paraqitur materiale të lëshuara nga burime jozyrtare dhe për më tepër jo sipas formës së kërkuar. Disponimi i makinerive të mësipërme mund të vërtetohet vetëm me anë të dokumentacionit që vërteton pronësinë si më sipër dhe kursesi nga një dokument që nuk përmban as firmë dhe as vulë të institucionit lëshues apo një dokument që mund të jetë në kuadër të vetdeklarimit. Ne jemi të bindur sipas eksperiencës me këtë kompani që nuk disponon makineri printimi në rrulon. Në vend të faturës së kësaj makinerie shoqëria duhet të ketë paraqitur faturën për makineri prerje dhe inspektimi. Pra kuptohet qartë se këto makineri janë të ndryshme dhe dokumentacioni i sjellë nuk vërteton makinerinë e kërkuar më lart. Në lidhje me makinerinë e printimit për të cilën mendojmë që mund të ketë paraqitur dokumentacion mendojmë se sërish ky dokumentacion nuk është konform legjislacionit në fuqi i përkthyer (me vulën e përkthyesit) dhe i noterizuar. Për pasojë kjo makineri nuk mund të merret në konsideratë për sa kohë nuk është sipas formës së kërkuar nga ligji nuk krijon bindjen për vërtetësinë e dokumentit dhe të vetë disponimit të makinerisë.
- Modelet (Mostrat) e paraqitura nga një shoqëri nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DT për arsye se:
 1. Nuk kanë numrin serial sipas specifikimeve teknike (ngjyrë, blu , refleks)
 2. Shkrimi në të nuk është sipas llojit të përcaktuar në specifikimet teknike dhe sipas madhësisë së kërkuar.
 3. Mungojnë elementët e sigurisë së kërkuar në specifikime teknike nuk janë sipas DST.

Në specifikimet teknike është përcaktuar qartë: **Pulla do të përfshijë të stampuar:**

a- Në krye të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë Blu Reflex e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE** me dimension 20 mm x 1 mm, me karakter Times Neë Roman (kapitale), të qendëruara, shtypur, mbi motivin e valëve, me ngjyrë Blu Reflex. Ne mendojmë se edhe me sy të lirë mund të dallohet që shkrimi nuk është i madhësisë së kërkuar por më i vogël. Punimi në ngjyrë të zezë është lehtësisht i arritshëm nga kompanitë prandaj enti juaj prokurues ka zgjedhur këtë ngjyrë për prodhimin e pullave. Rëndësia e këtij malli është e madhe për shkak të natyrës së vecantë dhe delikate që ka . Për këtë arsye numri serial me ngjyrë blu refleks me qëllim parandalimin e falsifikimeve duhet të jetë një kusht që duhet përmbushur patjetër sepse vetëm boja panton që kërkohet blu refleks nuk mund të bëhet me

printera sic i disponon institucioni juaj por me makineri me nje kosto shumë të lartë sepse printerat e mëdhenj nuk vendosin numrin me bojë panton dmth të vecantë. Ne mendojmë se kjo shoqëri nuk i ka realizuar këto elementë sikurse është kërkuar në DT. Sërish nga vështirimi me sy të lirë i modeleve të paraqitura nga shoqëria mendojmë se do të vihet re që vendosja e elementëve fosforeshentë (elementë sigurie) nuk është realizuar sipas specifikimeve në DST. Për më tepër që edhe adezivi që ngjitet pas pullës nuk e ka fortësinë e kërkuar dhe të përshkruar sipas specifikimeve teknike.

- Ne mendojmë se shoqëria Cetis nuk disponon ambient të përshtatshëm prodhimi dhe magazinimi për ruajtjen e mallit sepse dokumentacioni i paraqitur në përmbushje të këtij kriteri nuk plotëson snjë prej kushteve të mësipërme. Kjo shoqëri ka paraqitur një deklaratë për të vërtetuar ambjentet me firmë dhe vulë të shoqërisë Cetis por jo nga autoriteti përkatës kompetent (institucioni lëshuar). Kështu ky dokument nuk është i vlefshëm sepse nuk është lëshuar sipas rregullave të legjislacionit shqiptar. Në kushtet kur në kriter përcaktohet qartë paraqitjen e AKT Pronsësie ose kontratë qeraje të shoqëruar me dokumentacionin përkatës që e vërteton atë ju bëjmë me dije se dokumentacioni nuk është as origjinal as kopje e noterizuar. Gjithashtu vendosja e vulës apostile në dokumenta nuk bëhet për deklarat e dala nga një kompani si Cetis por realizohet vetëm për dokumentat e institucioneve shtetërore.
- Argumentimi i ofertës anomalisht të ulët të paraqitur nga shoqëria Cetis nuk është në përmbushje të LPP. Duke parë renditjen e shoqërisë Cetis dhe vlerën e ofertuar si dhe duke patur parasysh faktin që kjo shoqëri nuk ka marrë pjesë më përpara në këtë tender ju bëjmë me dije se vlera është anomalisht e ulët. Bazuar në këtë oferta ekonomike e kësaj kompanie është e ulët dhe përbën rezik për mosrealizimin e saj me sukses në përputhje me nenin 56 të legjislacionit të prokurimiti publik kjo shoqëri duhet të përshkruajë proceset e punës. Vetëm po të provojë me fakte të mirpërcaktuara se cilat janë avantazhet e kësaj shoqërie që kostoja ka dalë shumë e ulët mund të përliqjet apo të justifikohet cmimi i ofertuar. Ne mendojmë se kjo shoqëri nuk ka dhënë shpjegimet e duhura si më sipër shpjegim i cili sipas ligjit duhet të jetë i bazuar në dokumentacion shtesë vërtetues. Shoqëria Cetis nuk ka dhënë koston/cmimin për bojën blu reflekx dhe llakimin e pullës sipas specifikimeve teknike. Kjo vjen si rezultat dhe i mangësisë që ka kjo shoqëri në makineritë e shpjeguara në pikën 6 makineri printimi dhe llakimi në rulon. Kjo shoqëri nuk e ka provuar këtë cmim as me anë të faturave tatimore të shitjes apo dokumenta të tjerë justifikimin e bazës materiale duke bërë që oferta të mos justifikojë fondin limit të vendosur nga institucioni juaj. Për sa më sipër këkrojmë skualifikimin e kësaj shoqërie nga kjo procedurë prokurimi.

2. Gjithashtu kërkojmë skualifikimin e shoqërisë Albdesign PSP shpk për mungesë të theksuar dokumentacioni si vijon:

- Ne mendojmë se Ekstraktet historike dhe tregëtar (të paktën jo në cdo fletë sikurse QKB i lëshon) nuk janë origjinale apo kopje të njohura me origjinalin sic kërkohet në DST. Referuar parashikimeve ligjore dhe dokumentave të tenderit përcaktohet që dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar nga origjinali.
- Ne mendojmë se Formulari i ofertës së kësaj shoqërie nuk përmban shumën në shifra por vetëm në fjalë duke mos qenë i rregullt sipas DST dhe LPP.
- Gjithashtu Formulari ku shprehet lista e informacionit konfidencial si dokumentat dhe modelet e paraqitura në tender nuk është e paraqitur nga kjo shoqëri duke mos respektuar kërkesën e përcaktuar në DST.
- Modelet e paraqitura në ditën e hapjes së ofertave nuk janë në përputhje me specifikimet teknike si vijon:
 1. Numri serial i pullës nuk është me ngjyrë blu reflex sic kërkohet por është në ngjyrë të zezë.
 2. Gjithashtu mungojnë elementët e sigurisë të përcaktuara në specifikimet teknike. Në modelin e paraqitur vihet re se nuk janë respektuar specifikimet si boja UV me ngjyrë reflex, distancat në mm, ngjyra pantone etj por më flagrantja është fakti se cmimi i dhënë justifikohet vetëm nëse i gjithë punimi realizohet me ngjyrë të zezë gjë që do ishte kundër DST. Ky shkrim realizohet me printerin inkjet nuk ka kosto të lartë dhe realizohet lehtësisht nga kompanitë. Ndryshe nga boja Blu reflex e cila ndryshon në punim kërkon parapërgatitje (pantone) dhe ka kosto të lartë. Këtë gjë shoqëria Albdesign nuk e kishte realizuar. Gjithashtu boja fluoreshente që supozohet të duket vetëm nën dritën e llapës UV në fakt ne mendojmë se ajo duket me sy të lirë duke u bërë një arsye më shumë që tregon për kapacitetin teknik të realizimit të pullës dhe mangësitë teknike të pullës nga kjo shoqëri.
- Në DT kërkohet: 3- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë ambjent të përshtatshëm, prodhimi dhe magazinimi për ruajtjen e mallit. Për kete te paraqese: Akt pronesie ose kontrate qeraje te shoqeruar me dokumentacion perkates qe e verteton ate (kontrata te perfshije vitet 2018-2019), të cilat duhet të jenë origjinale ose të noterizuara. Kontrata e qerasë së godinës e paraqitur nga shoqëria Albdesign PSP është e pavlefshme pasi është hartuar në kundërshtim me legjislacionin Për noterinë i ndryshuar. Në kushtet kur kjo kontratë është e lidhur në kundërshtim me ligjin kjo shoqëri duhet të ishte skualifikuar nga kjo procedurë.
- Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: Kopje të çertifikuara të balanceve, të tre viteve të fundit financiar, të paraqitura në autoritetet përkatëse; Ne mendojmë se dokumentacioni i paraqitur në përmbushje të këtij kriteri është paraqitur në kundërshtim me DT dhe legjislacionin në fuqi. Ky dokumentacion nuk është sipas formës ligjore të përcaktuara nga ligji. Gjithashtu ne mendojmë që bilanci i vitit 2015 është paraqitur i pashoqëruar me raportin e auditit pjesë integrale e bilancit. Bilanci vjetor kontabël dhe raporti i auditit dorëzohen së bashku në DT. Pra raporti i auditit është pjesë integrale dhe e pandashme e pasqyrave financiare. Në këto

kushte argumentojmë se bilanci duhet të dorëzohet së bashku me raportin e auditit. Duke qenë se kjo firmë nuk i ka paraqitur raportet e auditit për bilancin e viteve 2015 2016 është në kundërshtim me ligjin pasi nuk tregon gjendjen reale të pasqyrave financiare.

- Në DT kërkohet: *Certifikate ISO 9001: 2015 të "Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë"*. Ne mendojmë se certifikata e paraqitur nga kjo shoqëri nuk është lëshuar nga organet kompetente. Si e tillë rezulton me paregullsi në afate apo përsa i përket vlefshëmrisë së saj. Certifikata e paraqitur mban një afat 5 vjeçar ndërkohë që nga praktika e organeve certifikuese dhe audituese këto certifikata lëshohen me një afat 3 vjeçar. ISO është një standart ndërkombëtar ndaj këto rregulla përcaktohen njëllë për të gjithë. Gjithashtu ne mendojmë se kjo certifikatë nuk është lëshuar nga organe të akredituara sic përcaktohet nga legjislacioni në fuqi. Ne kemi bindjen që kjo certifikatë nuk është lëshuar nga trup certifikimi të njohur nga RSH sikundër përcaktohet në DT.
- Nuk disponon makineri llakimi në rrulon dhe makineri numratori dixhital sic përcaktohet në pikën 4 e cituar me sipër. Problemi i parë lidhet me faktin se kontrata e qerasë është mes Albdesign PSP dhe ADPS për dhënien me qera të makinerive Xeikon është një kontratë e pavlefshme sepse ne kemi bindjen që aktualisht këto makineri janë në gjendje pune dhe në funksion të realizimit të një kontrate me afat 1 vjeçar informacion të cilin ne e kemi të sigurt për shkak të pjesëmarrjes sonë në të njëjtin tender me këtë qeradhënë. Duke qenë se kjo kontratë është në realizim e sipër aktualisht në UKT sha do të thotë se makineritë e marra me qera janë të angazhuara në kontratë tjetër me objekt printim zarfim faturash dhe nuk shërbejnë për realizimin me sukses të kontratës që prokurohet. Po ju vëmë në dispozicion ankesën që kemi bërë pranë UKT dhe vendimet e KPP për këtë problem që flet se kur makineritë janë angazhuar në një kontratë tjetër nuk mund të përdoren në një kontratë tjetër. Ne kemi bindjen se në këtë tender ka paraqitur të njëjtat makineri që i janë dhënë me qera Albdesign PSP dhe meqënëse se Adel Co ka marrë pjesë në atë tender e ka këtë informacion. Me lidhjen e kontratës ADPS rezulton se ka akoma në zhvillim e sipër kontratën me UKT . Për sa më sipër ne mendojmë se kontrata e qerasë e paraqitur është fiktive vetëm me qëllim përdorimi në tender.

Nga ana tjetër nëse marrim të mirqenë disponimin e makinerive ju bëjmë me dije se Xeikon 500 nuk i shërben kontratës së kësaj procedure prokurimi. Në përshkrimin e bërë në kontratë ku pretendohet dhe specifikohet që me këtë kontratë realizohen procese si llakimi apo vendosja e numrit serial ky përshkrim nuk ka vlerë ligjore pasi nuk është i mbështetur në dokumentacion. Ne e disponojmë këtë makineri edhe në ambjentet tona dhe mund të vërtetojmë në mënyrë absolute se kjo makineri nuk shërben edhe si makineri printimi edhe si makineri llakimi pasi në specifikimet e përkthyer të kësaj makinerie nuk është përmendur llakimi dhe në dalje rotative por po të shikohet me kujdes thuhet A4 pra e prerë A4 në sp teknike në shqip nuk përmendet nga i gjeti kjo notere këto funksione. Më konkretisht në skedën teknike të makinerive Xeikon (e cila është edhe e përkthyer dhe pjesë e kontratës së qerasë nuk përshkruhet asnjë nga funksionet e përcaktuara në kontratën e qerasë. Pra këto makineri të paraqitura nuk mund të zëvendësojnë kursesi makinerinë e llakimit në rrulon sikurse është kërkuar në DST. Kërkojmë verifikimin e këtyre informacioneve të nxjerra në lidhje me këtë makineri si dhe përgjigje për pyetjet:

A e kryen funksionin e llakimit makina DPC 500 Xeikon??

A e nxjerr letrën në formë bobine??


A printon në letër Adezive??

- *Në dokumentacionin e paraqitur për makinerinë e numratorit dixhital në skedën teknike dhe në dokumentacionin e paraqitur për makinerinë e marrë me qera nuk rezulton asnjë e dhënë për këtë makineri. Në total janë kërkuar 3 makinieri dhe vërtetimi i këtyre tre makinierive është kusht kumulativ dhe jo alternativ. Pra ky operator ka paraqitur dokumentacion provues vetëm për makineri printimi në rrulon duke mos paraqitur kështu dokumentacion për makinieri llakimi në rrulon dhe për makineri numrator dixhital. Për s a më sipër ky OE duhet të skualifikohej nga kjo procedurë prokurimi.*

II.8. Në datën 19.06.2018, me shkresën nr.2104/37 prot, operatori ekonomik “Adel Co ” shpk., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.9. Në datën 26.06.2018 pala ankimuese “Adel Co” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr.2104/43 prot, datë 02.07.2018, protokolluar me tonën me nr.117/2 prot datë 02.07.2018 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.



III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Albdesign PSP” shpk dhe “Adel Co” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Cetis Graphic and Dokumentation Service” me arsyetimin se *Oferta ekonomike e operatorit Cetis është anomalisht e ulët dhe në djetinë tonë mendojmë se nuk ka përmbushur dhe plotësuar të katër kushtet kumulative të përcaktuara në nenin 56 të LPP. Operatori ekonomik Cetis nuk ka argumentuar dhe dokumentuar me prova shkresore duke mbajtur në konsideratë të gjithë elementët të përcaktuar në Ligj dhe VKM ndaj oferta e tij nuk duhet pranuar si një ofertë që nuk krijon bindjen për realizimin me sukses të kontratës. Mosargumentimi i ofertës së paraqitur me dokumenta dhe prova shkresore dhe kualifikimi i tij në kundërshtim me përcaktimet e ligjit do të çojnë në një mosrealizim të kontratës pasi vlera e paraqitur nga operatori Cetis është gati 50% më poshtë se fondi limit duke paraqitur një rezik në kryerjen dhe realizimin e kontratës në cilësi dhe në kohë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Me shkresën nr.2104/21 prot datë 01.06.2018 autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik “Cetis Graphic and Dokumentation Services” kërkesë për shpjegime mbi ofertën anomalisht të ulët.

III.1.2. Me datë 04.06.2018 operatori “Cetis Graphic and Dokumentation Services” i ka kthyer përgjigje autoritetit kontraktor mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët të paraqitur prej tij me përmbajtje si vijon: *Lidhur me shkresën tuaj me të cilën verifikoni nëse kemi dhënë një ofertë të përshtatshme (përfshirja e të gjitha kostove) ju informojmë se shoqëria Cetis sha ka disa dekada përvojë në fushën e shtypit të mbrojtur , zotëron zonat e mbrojtura, pajisjet e nevojshme, punonjësit me përvojë, dhe procedurat e duhura për kryerjen e një biznesi të tillë. Cetis gjatë përgatitjes së ofertës ka marrë në konsideratë të gjitha elementët për prodhimin e etiketave mjekësore dhe produkteve të tjera. Ne kemi marrë parasysh cmimet për materialet e hyra të marra nga furnizuesit tanë të verifikuar paraprakisht. Cmimi mbulon të gjithë prodhimin (të gjitha kostot, duke përfshirë edhe mbrojtjen e ndërtesës dhe transportin në lokacion. Cmimi në total i ofertës pa tvsh ishte 9,955,800.00 lekë.*

Ndarja e cmimit të ofertës sipas pikave është si vijon:

<i>Prodhimin 9 (të gjitha kostot)</i>	<i>4,088,900.00 lekë</i>
<i>Përgatitja për printim (dizajn)</i>	<i>24,700.000 lekë</i>
<i>Printimi (makina OMET)</i>	<i>1,342,200.00 lekë</i>
<i>Përpunimi dhe numeracioni (makina domino, venus)</i>	<i>2,722,000.00 lekë</i>
<i>Materiali</i>	
<i>Të gjitha materialet e nevojshme për prodhimin e etiketave mjekësore, thelbi dhe shiritat</i>	<i>5,561,900.00 lekë</i>
<i>Transporti (dorëzimi)</i>	<i>305,000.00 lekë</i>
<i>Total</i>	<i>9,955,800.00 lekë</i>

Cetis d.d deklaroi që i kemi verifikuar cmimet në treg, kemi marrë oferta nga furnizuesit dhe do të jemi në gjendje të kryejmë punën sipas cmimit të ofruar.

III.1.3. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.*

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.1.4. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]”

III.1.5. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangijen e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e

kontratës dhe kosto që i linden autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj.

III.1.6. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Cetis ” sh.p.k në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ankimuesi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës ose provues si: fatura tatimore, fletë zhdoganimit, kontrata furnizimi, apo ndonjë dokument tjetër, që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Akoma edhe më tej, referuar shkresës datë 05.06.2018 nga operatori ekonomik Cetis rezulton se është deklaruar se *“Ne kemi marrë parasysh cmimet për materialet e hyra të marra nga furnizuesit tanë të verifikuar paraprakisht. Cmimi mbulon të gjithë prodhimin (të gjitha kostot, duke përfshirë edhe mbrojtjen e ndërtesës dhe transportin në lokacion ndërkohë që nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion (marrëveshje, faturë tatimore) për të vërtetuar këtë fakt.*

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se shoqëria “Cetis”, përveç argumentimit të vet në formën e një deklarate, nuk ka paraqitur *prova shkresore për elementet* e ofertës sikurse kërkuar, pranë autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik ankimues ka detyrimin ligjor që të prezantojë me dokumentacion provues zgjidhjet teknike dhe/ose ndonjë kusht favorizues që do të garantonin realizimin e objektit të kontratës pranë autoritetit kontraktor. Paraqitja e deklaratës në përmbajtje të së cilës pasqyrohet vetëm kostot/cmimi për elementët e realizimit të kontratës i pashoqëruar me dokumentacionin shtesë provues nuk mund të konsiderohet si provë pasi në vetvete nuk provon dhe garanton ofertën ekonomike si dhe realizimin e punimeve.

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: *metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar*), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesve qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Adel Co” shpk dhe “Albdesign PSP” shpk mbi kualifikimin e shoqërisë “Cetis Graphic and Dokumentation Services”, Komisioni i

Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Cetis Graphic and Dokumentation Services” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesve.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Adel Co” për kundërshtimin e ofertës së operatorit ekonomik “Albdesign PSP” shpk me argumentat se “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: Kopje të çertifikuara të bilanceve, te tre viteve te fundit financiar, të paraqitura në autoritetet përkatëse; Ne mendojmë se dokumentacioni i paraqitur në përmbushje të këtij kriteri është paraqitur në kundërshtim me DT dhe legjislacionin në fuqi. Ky dokumentacion nuk është sipas formës ligjore të përcaktuara nga ligji. Gjithashtu ne mendojmë që bilanci i vitit 2015 është paraqitur i pashoqëruar me raportin e auditit pjesë integrale e bilancit. Bilanci vjetor kontabël dhe raporti i auditit dorëzohen së bashku në DT. Pra raporti i auditit është pjesë integrale dhe e pandashme e pasqyrave financiare. Në këto kushte argumentojmë se bilanci duhet të dorëzohet së bashku me raportin e auditit. Duke qenë se kjo firmë nuk i ka paraqitur raportet e auditit për bilancin e viteve 2015 2016 është në kundërshtim me ligjin pasi nuk tregojnë gjendjen reale të pasqyrave financiare”, Komisioni i prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentat e tenderit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Ishte: Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) Kopje të çertifikuara të bilanceve, të (tre) viteve të fundit financiare, të paraqitura në autoritetet përkatëse;

Bëhet: Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) Kopje të çertifikuara të bilanceve ,të tre viteve të fundit financiare (viti: 2015/2016/2017), të paraqitura në autoritetet përkatëse.

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik “Albdesign PSP” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Pasqyrat Financiare për Vitin 2015
- Pasqyrat Financiare për Vitin 2016 dhe Raporti i Audituesit të Pavarur
- Pasqyrat Financiare për Vitin 2017 dhe Raporti i Audituesit të Pavarur

III.3.3. Në nenin 46, pika 1 gëmbra “b” e Ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për

të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;”.

III.3.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji*

III.3.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, gjykojmë se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.3.6. Referuar dispozitës ligjore në fuqi në vitin 2015 nenit 41 i Ligjit 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” parashikohet shprehimisht se: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese,* parashikohet shprehimisht se:

Public Health Sector

Neni 41

Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare

Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:

a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar;

b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit;

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur në mbyllje të periudhës kontabël tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i) totali i aktiveve të bilanci, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 40 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 30 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.

III.3.7. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, KPP morri në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Abdesign PSP” shpk dhe verifikimin nëse ky operator përmbush dy nga kushtet kumulative të parashikuara në ligjin e sipërcituar për auditimin e pasqyrave financiare. KPP referuar pasqyrave financiare të dorëzuara nga operatori “Albdesign PSP” shpk konstaton se totali i aktiveve për vitin 2015 rezulton në shumën 54,173,498. Gjithashtu referuar vërtetimit Nr.T00308935 datë 21.05.2018 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë ky subjekt ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/ shërbimeve për vitin 2015 në shumën 71,210,928 lekë. Gjithashtu referuar listpagesave të subjektit për periudhën Qershor 2015-Dhjetor 2015 rezulton se shoqëria “Albdesign PSP” shpk, ka pasur fuqi mesatare të punonjësve 30 të punësuar.

Sa më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik “Albdesign PSP” shpk ka plotësuar të tre kushtet kumulative të vendosura nga legjislacioni në fuqi, për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore për vitin 2015, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria “Albdesign PSP” shpk rezulton se janë dorëzuar pasqyrat financiare për tre vitet e fundit nga ku konstatohet se për vitin 2016 dhe 2017 këto pasqyra financiar janë të shoqëruara me raportin e audituesit të pavarur në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ndërsa nuk rezulton të jetë dorëzuar raporti i auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2015. Në këto kushte KPP gjykon se ky operator ekonomik nuk ka zbatuar detyrimin ligjor për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2015.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” shpk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Adel Co” shpk për kundërshtimin e ofertës së operatorit ekonomik “Albdesign PSP” shpk me argumentat se “Nuk disponon makineri llakimi në rrulon dhe makineri numratori dixhital sic përcaktohet në pikën 4 e cituar me sipër. Problemi i parë lidhet me faktin se kontrata e qerasë është mes Albdesign PSP dhe ADPS për dhënien me qera të makinerive Xeikon është një kontratë e pavlefshme sepse ne kemi bindjen që aktualisht këto makineri janë në gjendje pune dhe në funksion të realizimit të një kontrate me afat 1 vjeçar informacion të cilin ne e kemi të sigurt për shkak të pjesmarrjes sonë në të njëjtin tender me këtë qeradhënës. Duke qenë se kjo kontratë është në realizim e sipër aktualisht në UKT sha do të thotë se makineritë e marra me qera janë të angazhuara në kontratë tjetër me objekt printim zarfim faturash dhe nuk shërbejnë për realizimin me sukses të kontratës që prokurohet. Po ju vëmë në dispozicion ankesën që kemi bërë pranë UKT dhe vendimet e KPP për këtë problem që flet se kur makineritë janë angazhuar në një kontratë tjetër nuk mund të përdoren në një kontratë tjetër. Ne kemi bindjen se në këtë tender ka paraqitur të njëjtat makineri që i janë dhënë me qera Albdesign PSP dhe meqënëse se Adel Co ka marrë pjesë në atë tender e ka këtë informacion. Me lidhjen e kontratës ADPS rezulton se ka akoma në zhvillim e sipër kontratën me UKT. Për sa më sipër ne mendojmë se kontrata e qerasë e paraqitur është fiktive vetëm me qëllim përdorimi në tender.

Nga ana tjetër nëse marrim të mirqenë disponimin e makinerive ju bëjmë me dije se Xeikon 500 nuk i shërben kontratës së kësaj procedure prokurimi. Në përshkrimin e bërë në kontratë ku pretendohet dhe specifikohet që me këtë kontratë realizohen procese si llakimi apo vendosja e numrit serial ky përshkrim nuk ka vlerë ligjore pasi nuk është i mbështetur në dokumentacion. Ne e disponojmë këtë makineri edhe në ambjentet tona dhe mund të vërtetojmë në mënyrë absolute se kjo makineri nuk shërben edhe si makineri printimi edhe si makineri llakimi pasi në specifikimet e përkthyer të kësaj makinerie nuk është përmendur llakimi dhe në dalje rotative por po të shikohet me kujdes thuhet A4 pra e prerë A4 në sp teknike në shqip nuk përmendet nga i gjeti kjo notere këto funksione. Më konkretisht në skedën teknike të makinerive Xeikon (e cila është edhe e përkthyer dhe pjesë e kontratës së qerasë nuk përshkruhet asnjë nga funksionet e përcaktuara në kontratën e qerasë. Pra këto makineri të paraqitura nuk mund të zëvendësojnë kursesi makinerinë e llakimit në rrulon sikurse është kërkuar në DST. Kërkojmë verifikimin e këtyre informacioneve të nxjerra në lidhje me këtë makineri si dhe përgjigje për pyetjet:

A e kryen funksionin e llakimit makina DPC 500 Xeikon??

A e nxjerr letrën në formë bobine??

A printon në letër Adezive??

- Në dokumentacionin e paraqitur për makinerinë e numratorit dixhital në skedën teknike dhe në dokumentacionin e paraqitur për makinerinë e marrë me qera nuk rezulton asnjë e dhënë për këtë makineri. Në total janë kërkuar 3 makinieri dhe vërtetimi i këtyre tre makinierive është kusht kumulativ dhe jo alternativ. Pra ky operator ka paraqitur dokumentacion provues vetëm për makineri printimi në rrulon duke mos paraqitur kështu dokumentacion për makinieri llakimi në rrulon dhe për makinieri numratori dixhital. Për s a më sipër ky OE duhet të skualifikohej nga kjo procedurë prokurimi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën modifikim mbi dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Ishte: 2- Dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

a) Operatori ekonomik duhet të disponojë makineri dhe pajisje e vërtetuar me fature blerje / me kontratë qiraje për pajisjet me qira, si më poshtë:

- makineri printimi dhe llakimi në rulon;
- makineri numerator dixhital.

Bëhet: 2- Dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

a) Operatori ekonomik duhet të disponojë makineri dhe pajisje e vërtetuar me fature blerje / me kontratë qiraje për pajisjet me qira, si më poshtë:

- makineri printimi dhe llakimi në rulon;

- *makineri numerator dixhital, ekuivalent ose multifunksionale*

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik “Albdesign PSP” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Qeraje nr.2194 Rep Nr.679 Kol datë 22.05.2018 lidhur ndërmjet Albanian Digital Printing Solution&Services shpk dhe shoqërisë Albdesign PSP shpk me objekt: Dhënia me Qera e pajisjeve si më poshtë:

Makineri Printimi Dixhitale në Rulon DCP500 Xeikon-2 copë

Faturë Tatimore Shitje Nr.91294 datë 02.08.2016 lëshuar nga Raiffeisen Leasing sha me përshkrim Makineri Printimi Dixhital me ngjyra Xeikon sasia një

Faturë Tatimore Shitje Nr.91293 datë 02.08.2016 lëshuar nga Raiffeisen Leasing sha me përshkrim Makineri Printimi Dixhital me ngjyra sasia një

Faturë Tatimore Shitje Nr.29 datë 31.12.2016 me përshkrim Makineri CTP (Computer to Plate Basys Print) për parapërgatje shtypi copë 1

Makineri Shtypi Offset format 70x100, 5 ngjyra sistem llakimi tharje copë 1

Makineri Shtypi Offset Komorr sprint format 50x70, 2 ngjyra copë 1

Makineri Qepse me pe copë 1

Furrë Polimerizimi Ultra Violet Gardina (Llakimi+ shtyp ultraviolet) copë 1

III.4.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.4.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.4.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në përmbushje të kriterit sa më sipër, Komisioni konstaton se operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k ka dorëzuar një kontratë qeraje me anë të së cilës provon se posedon dy makineri printimi *Dixhitale në Rulon DCP500 Xeikon* shoqëruar me faturat tatimore përkatëse si dhe një faturë tatimore nr.

Nr.29 datë 31.12.2016 nga ku rezulton se ka blerë disa makineri me përshkrim si vijon: Makineri CTP (Computer to Plate Basys Print), Makineri Shtypi Offset format 70x100, 5 ngjyra sistem llakimi, Makineri Shtypi Offset Komorr sprint format 50x70, 2 ngjyra, Makineri Qepse me pe, Furrë Polimerizimi Ultra Violet Gardina (Llakimi+ shtyp ultraviolet). KPP gjykon se me dokumentacionin e paraqitur operatori ekonomik “Albdesig PSP” ka provuar se disponon makineri printimi dixhitale në rulon si dhe makineri llakimi ndërsa nuk provohet disponimi i një makinerie numerator dixhital, ekuivalent ose multifunksionale, të kërkuar në kriterin e kualifikimit. Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave mbajtuar nga KVO pranë autoritetit kontraktor rezulton se kjo e fundit ka cituar se operatori ekonomik ka dorëzuar faturën Nr.29 datë 31.12.2016 me anë të së cilës provohet disponimi i makinerisë numerator dixhital, ekuivalent ose multifunksionale pa specifikuar në asnjë moment se cila prej 5 makinerive të përshkruara në faturën tatimore i takon pikërisht llojit të makinerisë të kërkuar në kriterin e kualifikimit (numerator dixhital, ekuivalent ose multifunksionale).

KPP gjykon se në faturën Nr.29 datë 31.12.2016 nuk përshkruhet asnjë informacion apo e dhënë që të con në përfundimin se operatori disponon një makineri që do funksionojë si numrator dixhital ose një makineri ekuivalente apo multifunksionale. KPP gjykon se i takon operatorit ekonomik të provojë se disponon kapacitetet e kërkuara në përputhje me kriteret kualifikuese. Në rastin konkret me dokumentacionin e paraqitur nuk provohet që operatori ekonomik “Albdesign PSP” shpk disponon një makineri numrator dixhital.

III.4.6. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k. nuk ka dorëzuar dokumentacion në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: “Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”;

“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;

b) transparencë në procedurat e prokurimit;

c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues duhe të kishte paraqitur të gjithë dokumentacionin në përputhje me kriteret dhe kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” shpk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Adel Co” shpk mbi kualifikimin e shoqërisë “Albdesign PSP” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik

“Albdesign PSP” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimesit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-53828-03-06-2018 me objekt: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, me fond limit 16.915.000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 23.05.2018 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe e Pajisjeve Mjekësore.
 2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
 3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorëve ekonomik “Cetis Graphic and Documentation Services” dhe “Albdesign PSP” shpk duke i skualifikuar ata.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Adel Co” shpk.
 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1177 Protokolli; Datë 25.06.2018

Nr.1186 Protokolli; Datë 26.06.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha